

PROGRES RAPORT

Procesi i konsultimeve publike në Bashkinë Shkodër



Zbatimi i ligjit Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Maj 2018



Ky raport u përgatit me iniciativën e shoqatës “Intelektualet e rinj, Shprese”, me mbështetjen financiare të Olof Palme International Center përmes financimit të Qeverisë Suedeze dhe Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Shqiptare. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e donatorëve.

Përmbajtja

1. Përmbledhje	4
2. Metodologjia	5
3. Gjetjet e progres raportit	6
4. Përfundime	8
5. Rekomandime	9
6. Analizë e legjislacionit shqiptar mbi njoftimin dhe konsultimin publik	10
7. Rezultatet e monitorimit	
7.1 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër	11
7.2 Njoftimi për konsultimet publike	12
7.3 Zhvillimi i konsultimeve publike	14
7.4 Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik	15
7.5 Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimarrëse	16
7.6 Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve	17
7.7 Raportet për transparencën në procesin e vendimarrjes	20

1. Përmbledhje

Në kuadër të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, organet publike duhet të orientohen drejt një qeverisjeje transparente dhe të hapur, ku publikut, brenda kornizave ligjore, duhet t'i garantohet e drejta për informim dhe njëkohësisht e drejta për të marrë pjesë në proceset vendimarrëse dhe politikbërëse të shtetit.

Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje, është një e drejtë e qytetareve në kuadër të qeverisjes, por po ashtu, përbën edhe një detyrim qytetar për të kontribuar në drejtim të një qeverisjeje të mirë. Në të dyja rastet janë institucionet publike të çfarëdo lloj niveli, që duhet të mundësojnë dhe të garantojnë një pjesëmarrje reale, efektive dhe gjithëpërfshirëse të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimarrjen lokale.

Për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të përmbushen tre komponentët kryesorë të tij: njoftimi, konsultimi dhe pjesëmarrja.

Në muajin Prill 2016, Shoqata “*Intelektualët e rinj, Shpresë*” publikoj raportin e parë mbi Transparencën në Bashkinë Shkodër duke u fokusuar në zbatimin e ligjit Nr. 119/2014, “*Për të drejtën e informimit*” dhe të ligjit Nr. 146/2014, “*Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*” nga ku rezultoi se procesi i konsultimit publik nuk zhvillohej në mënyrë korrekte nga ana e Bashkisë Shkodër në pjesën më të madhe të dispozitave ligjore.

Për monitorimin e progresit të arritur është grumbulluar informacion nëpërmjet kërkesave për informim, pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë në procesin e konsultimeve publike, komunikimeve informale dhe vëzhgimit të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër.

Progres raporti analizon zbatimin e legjislacionit për konsultimet publike, progresin e bërë nga Bashkia Shkodër dhe evidenton problematikat në zbatimin e ligjit.

Dy prej problematikave kryesore të cilat rezultojnë në këtë progres raport janë:

- 1) *mungesa e koordinatorit për njoftimet dhe konsultimet publike***
- 2) *mosrespektimi i afateve të njoftimeve për konsultimin publik.***

Rubrika e krijuar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër, për njoftimin e konsultimeve publike, konsiderohet progres pozitiv në përmirësimin e procesit të njoftimit të konsultimit publik në Bashkinë Shkodër. Po ashtu një tjetër zhvillim pozitiv krahasuar me raportin e mëparshëm është mbajtja e procesverbalit të takimeve konsultuese në formën e një dokumenti zyrtarë.

2. Metodologjia

Në realizimin e këtij raporti monitorimi është përdorur informacioni i grumbulluar nëpërmjet kërkesave zyrtare për informim, si dhe takimeve të organizuara si pjesë e procesit të konsultimeve publike dhe faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër <http://www.bashkiashkoder.gov.al>.

Metoda krahasuese ka shërbyer për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura në raportin e mëparshëm, të publikuar nga shoqata “Intelektualet e rinj, Shpresë” në Prill të vitit 2016¹

Gjithsej janë dërguar 10 kërkesa për informim, për të cilat është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, 10-ditorë. Janë analizuar rreth 17 publikime te njoftimeve në website të Bashkisë Shkodër për konsultime publike si dhe është marrë pjesë në 5 takime për konsultime publike.

Informacioni i grumbulluar është krahasuar me kuadrin ligjorë për realizimin e procesit të konsultimeve publike nga autoritetet publike duke u fokusuar në mënyren e realizimit të tij nga Bashkia Shkodër dhe mënyren e zbatimit të ligjit.

¹ Shih Raportin: <http://irsh.al/wp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-Transparences-Shqip.pdf>

3. Gjetjet e progres raportit

1. Bashkia Shkodër në website të saj ka krijuar një rubrikë “Këshillim me publikun“ ku publikohen njoftimet për konsultime publike, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Koment: Krijimi i kësaj rubrike shënon progres pozitiv në krahasim me raportin e parë të monitorimit të realizuar në Prill të vitit 2016.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 828, datë 7.10.2015, “ Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike, që i shërben rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes më të gjërë të publikut në vendimarrje, nëpërmjet krijimit të një portal online, dedikuar tërësisht, njoftimeve dhe konsultimeve publike nga autoritetet publike,

Koment: Vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave nuk është zbatuar duke qënë se ky portal nuk është i aksesueshëm nga Bashkia Shkodër.

3. Nga monitorimi rezulton se Bashkia Shkodër ka filluar të konsolidoj praktikën e publikimit të procesverbaleve të degjesave publike.

Koment: Publikimi i procesverbaleve shënon progres pozitiv në krahasim me raportin e parë të monitorimit të realizuar në Prill të vitit 2016 nga ku rezultonte se procesverbalet e takimeve konsultuese nuk mbaheshin në mënyrë të rregullt si dhe nuk publikoheshin

4. Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave, konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike“

Koment: Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm, në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike dhe me detyrat të përcaktuara qartë por Bashkia Shkodër akoma nuk ka caktuar një person që kryej detyrat e ngarkuara nga ligji.

5. Njoftimet për konsultimet publike sipas nenit 13 të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” duhet të përmbajnë informacione të rëndësishme të tilla si: arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë, afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre, adresa e

kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin, vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.

Koment: Nga këto 8 kritere të parashikuara vetëm 2 prej tyre zbatohen nga Bashkia Shkodër në njoftimet për konsultime publike të publikuara në website të këtij autoriteti publik ku në njoftim informacioni përmban vetëm datën dhe vendin e takimit.

6. Sipas nenit 15 të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet se koha e arsyeshme e cila duhet ti jepet palëve të interesuara për të dërguar pranë organit publik vendimarrës komentet dhe rekomandimet e tyre duhet të jetë të paktën 20 ditë pune nga data e njoftimit.

Koment: Nga monitorimi i njoftimeve për konsultimet publike në faqen zyrtare te internetit të Bashkisë Shkodër rezulton se afati minimal prej 20 ditësh pune kohe ndërmjet publikimit dhe datës së konsultimit, shkelet në mënyrë të vazhdueshme.

7. Sipas nenit 20 të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet se organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes

Koment: Nga monitorimi i realizuar nuk rezulton se janë publikuar raporte për transparencën në procesin e vendimmarrjes të realizuara nga Bashkia Shkodër, për vitin 2017 dhe as për vitet paraardhëse. Këto raporte janë të detyrueshme dhe duhet të përfshijnë këto informacione, numri i akteve të miratuara nga organi publik, numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numri i rekomandimeve dhe i komenteve të pranuar e të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes dhe numri i takimeve publike të organizuara.

4. Përfundime

Nga monitorimi i detyrimeve që rrjedhin prej legjislacionit në fuqi në lidhje me njoftimet dhe konsultimet publike për Bashkinë Shkodër, janë konstatuar shume problematika të cilat i kemi pasqyruar në këtë raport.

Nga monitorimi i Prillit të 2016, rezulton se ka pak ndryshime në zbatimin e ligjit për njoftimet dhe konsultimet publike. Nga 19 kritere të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, të analizuar rezulton se vetëm 4 nga këto kritere plotësohen nga Bashkia Shkodër gjatë zhvillimit të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Nëse kjo pasqyrohet në përqindje rezulton së Bashkia Shkodër e zbaton ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, në masën 21%.

Ndërsa në raport me progresin e arritur nga monitorimi i mëparshëm, për zbatimin e këtij ligji, rezulton se në Raportin e Prillit 2016 , Bashkia Shkodër kishte të plotësuar 2 kritere nga 19 që parashikon ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasqyruar në përqindje, domethënë, 10.5%.

Bashkia Shkodër përdor website e saj për të publikuar njoftimet për konsultime publike, ky është një hap pozitiv për të rritur transparencën dhe për të rritur pjesëmarrjen në procesin vendimarrjes së qytetareve.

Praktika e publikimit të procesverbaleve të takimeve për konsultimet publike vlerësohet, gjithashtu, si një hap pozitiv sepse në monitorimin e mëparshëm ishim në një situatë ku nuk mbaheshin procesverbale në menyre të rregullt nga drejtuesit vendorë.

Nga monitorimi vërehet se ka mangësi në zbatimin korrekt të ligjit, sidomos në zbatimin e afateve dhe mungesën e koordinorit përgjegjës për njoftimet dhe konsultimet publike.

5. **Rekomandime**

Në përfundim të monitorimit rekomandojmë:

- 5.1 Bashkia Shkodër duhet të caktoj menjëherë kordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik;
- 5.2 Të respektohet afati ligjor për dhënien e rekomandimeve, prej 20 ditësh punë, nga momenti i publikimit të aktit duke i dhënë kohën e mjaftueshme personave të interesuar të japin rekomandime apo opinionet e tyre.
- 5.3 Bashkia Shkodër për projektakte të rëndësishme të tilla si projekt-buxheti të vendosi afate më të gjata, deri në 40 ditë pune siç përcakton edhe ligji;
- 5.4 Të plotësohen kriteret për njoftimin dhe konsultimet publike, duke përfshirë të gjithë elementet e domosdoshme të përcaktuar nga neni 13\1, i ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- 5.5 Rekomandohet që në website të Bashkisë Shkodër të bëhen ndryshime duke krijuar një rubrikë më të organizuar për Konsultimet Publike ku të përfshihet i gjithë informacioni i kërkuar ligjorë, si model krahasues mund të merret Bashkia Tiranë;
- 5.6 Të zbatohen rregullat dhe kriteret e përcaktuara në VKM-së nr. 828, datë 7.10.2015, “ Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike”.
- 5.7 Bashkia Shkodër duhet të kthej në praktike pune hartimin dhe publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes ku të tregohet numri i akteve të miratuara nga organi publik, numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numri i rekomandimeve, komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes si dhe numrin e takimeve publike të organizuara, duke qënë se në këtë mënyrë mund të vlerësohen rezultatet e konsultimeve publike të zhvilluara;
- 5.8 Stafi i Bashkisë Shkodër duhet të trajnohet për një njohje dhe zbatim më të plotë dhe më të mirë të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në mënyrë që qytetarët, organizatat jofitimprurëse dhe çdo person i interesuar ti ofrohet mundësia e pjesëmarrjes në konsultimet publike, në mënyrë që të bëhen faktor në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet rekomandimeve dhe komenteve, por edhe që të informohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë për nismat vendimarrëse të Bashkisë Shkodër;

6. Analizë e legjislacionit shqiptar mbi njoftimin dhe konsultimin publik

a. Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ka si objekt organizimin dhe funksionimin e njesive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre, e të organeve përkatëse. Në këtë ligj përcakohet detyrimi dhe përgjegjësia e njesive të qeverisjes vendore për transparencë, konsultim dhe pjesëmarrje qytetare gjatë vendimarrjes.

b. Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ai përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Transparenca është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

Ligji ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.

c. VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike”

Kjo VKM ka parashikuar krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) dhe publikimin e tij në formën e një portali elektronik, faqeje web-i, me adresë elektronike: <http://www.konsultimi publik.gov.al>.

7. Rezultatet e monitorimit

7.1 Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër, http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkia_155_1.php, njoftimet për konsultime publike publikohen në një rubrike të vecantë “ Këshillim me Publikun”. Për vitin 2017 në këtë rubrikë janë bërë 16 publikime për konsultime publike, nga të cilat një është publikim për të njoftuar kalendarin e takimeve për projekt programin për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Shkodër.

Fig. 1. Faqe zyrtare Bashkia Shkodër, Publikimet e njoftimeve për konsultim publik



The screenshot shows the website interface for the Municipality of Shkodër. At the top, there is a navigation menu with options like 'Kreu', 'Bashkia', 'Këshilli Bashkiak', 'Programi i Transparencës', and 'Këshillim me Publikun'. Below the navigation, there are several tabs: 'Rreth Shkodrës', 'Vizitori', 'Për Biznesin', and 'Për Qytetar'. The main content area is titled 'Këshillim me Publikun' and shows a list of results. The first result is dated 21.12.2017 and is titled 'Njoftim për Këshillim me Publikun - Draft Rregullorja për administrimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër'. The second result is dated 14.12.2017 and is titled 'Njoftim për Këshillim me Publikun - Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetejeve të Ngurta Urbane'. Each result includes a brief description and the name of the initiator, 'Sekretaria e Këshillit të Bashkisë Shkodër'.

Për njësitë e vetëqeverisjes vendore publikimi konsultimeve publike është një detyrim që përcaktohet në **nenin 15, pika 1 dhe 2 e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”**, në të cilën citohet: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimitarisë së tyre. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqën zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike”.

Koment 1: Bashkia Shkodër në progres nga raporti i mëparshëm tashmë ka një rubrikë për konsultimet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër që është një hap pozitiv. Vërejmë se rubrika aktuale “Këshillim me Publikun” nuk i përgjigjet terminologjisë ligjore të duhur, duke qënë se ligji përdor termin “Konsultim Publik”. Propozojmë që të reflektohet nga Bashkia Shkodër në lidhje me këtë.

Fig. 2. Model për ndërtimin e rubrikës për njoftimet për konsultimet publike, marrë nga website e Bashkisë Tirane.



7.2 Njoftimi për konsultimet publike

Njoftimi përbën hapin fillestar të një procesi konsultimi dhe mbart një rol të madh në mbarëvajtjen e tij. Ai duhet të garantojë transparencë, aksesueshmëri, gjithëpërfshirje, si dhe efektivitet të procesit.

Në nenin 6 të ligjit **Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”**, përcaktohet detyrimi që kanë autoritetet publike për njoftimin dhe konsultimin publik. Sipas këtij neni organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, për këtë qëllim ato duhet që të përfshijnë:

- a) publikimin në **regjistrin elektronik** të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;
- b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;
- c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

Regjistri elektronik është një faqe interneti që shërben si bazë të dhënash dhe si vend për të afishuar draftet.

Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike”, është krijuar dhe funksionon Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në Republikën e Shqipërisë, kjo VKM ka hyrë në fuqi dhe subjekt i saj është çdo organ publik i ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.”

Bashkia Shkodër, në bazë të pikës 16, vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 828, datë 7.10.2015, ka detyrim që “deri në krijimin dhe bërjen funksional të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, konsultimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duhej bërë përmes faqes zyrtare të çdo institucioni”.”

Pika 11 e VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, parashikon se: “Çdo organ publik i ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duhet të caktojë një punonjës të administratës, përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur dhe hedhur në formatin e duhur, në faqen e web-it ”.”


Në varësi të formës së përzgjedhur të konsultimit, njoftimi duhet të bëhet me mjete dhe mënyra jo vetëm efikase, por edhe që gëzojnë aksesueshmëri të madhe nga publiku apo palët e interesuara. Kjo do të thotë që në varësi të projektaktit, dhe subjekteve që ju drejtohet, përdoret menyra më efikase për njoftimin, për shembull, në rast se do të diskutohet një projektakt që do të ndikojë në komunitetin rom dhe egjiptian, njoftimi elektronik nuk do të ishte i përshtatshëm, për shkak të specifikave social-kulturore që ky komunitet ka.

Koment 2: Në raportin e mëparshëm nuk rezulton që website Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike të ishte në funksionim. Nga monitorimi i website Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, nuk rezulton që Bashkia Shkodër të ketë akses në këtë website.

Koment 3: Nga komunikimet zyrtare me Bashkinë Shkodër, situata vazhdon si në raportin e parë, nga ku rezulton se nuk ekzistojnë plane vjetore të Bashkisë Shkodër që lidhen me procesin e vendimarrjes. Në programin e transparencës në website të Bashkisë Shkodër, gjithashtu nuk ka të publikuar asnjë raport vjetore për procesin e vendimarrjes, ashtu siç parashikohet në ligj që është miratuar në Tetor 2014 dhe ka hyrë në fuqi në muajin Maj të vitit 2015.

Rekomandohet që Bashkia Shkodër të marrë përsipër detyrimet që vijnë nga ligji dhe të krijojnë mundësinë që të kenë akses në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Fig. 3. Faqja zyrtare e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike



7.3 Zhvillimi i konsultimeve publike

Ligji e ka lënë në zgjedhjen e organit publik organizimin ose jo të takimeve publike për konsultimin e projektakteve. Megjithatë, nëse nuk organizohet një takim publik, organi nuk shkarkohet nga detyrimi për të kryer konsultimin publik. Në këto raste konsultimi zhvillohet duke dorëzuar me shkrim opinionet dhe rekomandimet, nëpërmjet dorëzimit në zyrat e organit publik, me postë, ose me email.

Në pikën 2 të nenit 6 të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet se:

“Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar”.

Koment 4: *Nga monitorimi i websitë të Bashkisë Shkodër rezulton se në shumicën e konsultimeve publike janë publikuar procesverbalet e konsultimeve. Kjo vlerësohet si hap pozitiv nga monitorimi i mëparshëm nga ku ishin evidentuar shume mangësi në mbajtjen e procesverbaleve, të cilat nuk publikoheshin.*

7.4 Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik është një person përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në çdo organ publik.

Në nenin 10, të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet se:

“Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj.”

Ky detyrim është i parashikuar gjithashtu në **nenin 16, pika 2 e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”** ku parashikohet se: *“Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik”.*

Në ligj është parashikuar vetëm detyrimi i organeve për të caktuar një koordinator, ndërsa detyrat dhe kompetencat e koordinatorit janë përcaktuar në VKM nr. 828, datë 07.10.2015 sipas së cilës koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik ka detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:

- 1. Është përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur të gjithë projektaktet e iniciuar nga të gjitha strukturat dhe departamentet e autoritetit përkatës;*
- 2. Publikon projektaktet në formatin e duhur, në faqen e internetit;*
- 3. Përditëson në mënyrë të vazhdueshme Regjistrin;*
- 4. Kujdeset për zbatimin e afateve të parashikuara në ligj dhe në VKM.*

Koment 5: Nga monitorimi i zhvilluar nuk rezulton se ka një person i cili kryen këtë funksion. Pozicioni i koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik megjithëse i parashikuar nga dy ligje dhe përshkruar më në detaje nga VKM-ja, nuk figuron në asnjë publikim për konsultim publik në website të Bashkisë Shkodër. Kjo mangësi në zbatimin e ligjit është evidentuar edhe në raportin e pare, por situata vazhdon të jetë e njëjtë.

7.5 Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse

Neni 13, i ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” përcakton kriteret që duhet të ketë një njoftim për konsultim publik. Nga monitorimi i njoftimeve për konsultime publike të njoftuara nga Bashkia Shkodër në faqën e saj të internetit dhe ballafaqimi me kriteret që përcakton ligji vihen re këto problematika.

Sipas pikës 1 të nenit 13 në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:

- a) *arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë; në të gjitha njoftimet për konsultimet publike, jepet emri projektaktit që do të konsultohet por nuk bëhen të ditura, arsyet për nxjerrjen e tij dhe çfare ndikimi do të ketë ai;*
- b) *afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; kjo pikë e këtij neni paraqet gjithashtu mangësi në aplikim, pasi shumica e njoftimeve në website të Bashkisë Shkodër, nuk shënohet, mënyra si do të paraqiten pranë institucionit, opinionet apo rekomandimet e paleve të interesuara.*
- c) *adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin; Po ashtu siç u theksua edhe më lart nuk rezulton një person me këtë pozicion dhe si rrjedhojë, nuk tregohet adresa e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të Bashkisë Shkodër*
- d) *vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij; kjo pikë e këtij neni është zbatuar, sepse në publikimet janë të përfshira ora, data dhe vendi i zhvillimit të takimit.*

Koment 6: Zbatimi i këtyre kriterëve ligjore vazhdon të mbetet problematike. Nga raporti i mëparshëm, rekomandohej që në njoftimet për konsultime, Bashkia e Shkodrës të kushtojë vëmendje kriterëve që një njoftim duhet të ketë në mënyrë që të ofrojë informacionet e nevojshme për personat e interesuar për procesin e vendimarrjes.

Neni 14¹ e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, parashikon se: *“Palët e interesuara që do të konsultohen, pajisen me informacionin e nevojshëm për t’u krijuar atyre mundësinë të kontribuojnë në mënyrën më efektive të mundshme në procesin e përgatitjes së projektaktit në rrugë elektronike dhe/ose postare”.*

Koment 7: Kjo pikë e ligjit është zbatuar në mënyrë të rregullt nga Bashkia Shkodër, shumica e publikimeve për konsultim publik janë të shoqëruara nga projektaktet përkatëse që do të diskutohen në dëgjesat publike. Përrjashtim bëjnë konsultimet për projektin e Bypass Shkodër që nuk ka të publikuar materialet që do të konsultohen në takim.

Është zhvillim pozitiv që njoftimet për konsultime publike janë të shoqëruara me materialet përkatëse, theksojme, se për projekte të një rendësie të vëcante si Bypass Shkodër, materialet mungonin dhe rekomandohet që nuk duhet të ketë përjashtim nga ky rregull, në mënyrë që të bëhet një konsultim publik sipas dispozitave ligjore.

7.6. Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

Në mënyrë që konsultimi të jetë efektiv, palët e interesuara duhet të kenë kohën e arsyeshme që të njihen me projektaktin dhe të hartojnë komentet dhe/ose rekomandimet përkatëse.

Në nenin 15 të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, janë përcaktuar afatet për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve ku afati minimal është 20 ditë pune ndërsa për rastin e akteve komplekse ose të rëndësishme ky afat mund të jetë deri në 40 ditë pune.

Po ashtu **në pikën 2 të Nenit 17 të këtij ligji** përcaktohet se: *“Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet”*.

Shoqata “Intelektualet e Rinj, Shprese”, ka ushtruar të drejtën e saj të parashikuar në **nenin 21, pika 1\ b e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”**, i cili parashikon se:

“Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen:

b) pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit”.


Për shkak të mosrespektimit të afateve ligjore të përcaktuar në nenin 17\2 të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në gjatë procesit të konsultimeve për buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afatmesëm 2018-2019 të organizuara nga Bashkia Shkodër me datën 10 Shkurt 2017 ka dorëzuar një ankim të Komisioneri për të Drejtën e Informimit Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kundër Bashkisë Shkodër,

Komisioneri për të Drejtën e Informimit Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2017 ka marrë 5 vendime, me objekt shkeljen e legjislacionit për konsultimet publike, nga të cilët **me vendimin nr. 54 datë 21. 05.2017**, iu dha të drejtë pretendimeve të IRSH-së.

Në këtë vendim u konstatuan shkeljet e afateve ligjore nga ana e Bashkisë Shkodër, të cilat edhe sipas citimit të vendimit *“ Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik , në nenin 17, pika 2, parashikon afatet taksative të njoftimit për palët e interesuara të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike duke iu dhënë kohën e nevojshme për përgatitje dhe vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.”*

Për më tepër ky vendim është pasqyruar në këtë link http://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/Vendim_nr_54-Bashkia_Shkoder.pdf .

Fig.4. Vendimi nr. 54, datë 21.05.2017, marrë nga website e Komisioneri për të Drejtën e Informimit Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



Koment 8: Nga monitorimi konstatohet se dizpozitat ligjore të mësipërme nuk zbatohen, në njoftimet e publikuara në website të Bashkisë Shkodër, afati minimal prej 20 ditësh pune kohe ndërmjet publikimit dhe datës së konsultimit, shkelet në menyrë të vazhdueshme. Kjo shkelje është evidentuar edhe në raportin e pare të realizuar, duke cenuar të drejtën e palëve të interesuara për të pregatitur rekomandimet e tyre, minimalisht brenda 20 ditësh. Afatet janë kryesisht me pak se 20 dite dhe mandje në një rast flagrant ishte vetem 3 dite.

Fig. 5. Faqja Zyrtare e Bashkise, konsulto online, Për miratimin e Plan veprimit për përmirsimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër.



Koment 9: Vemendje më të veçantë duhet ti kushtohet projektakteve për buxhetin, për ndryshimet e paketës fiskale, shpenzimeve dhe investimeve, të cilat kërkojnë një përfshirje edhe më të gjerë të qytetareve dhe grupeve e interesit. Edhe në këto raste afatet janë të shkurtra.

Theksohet rëndësia e zbatimit të afateve ligjore nga ana e Bashkisë Shkodër në të gjitha njoftimet për konsultimet publike dhe për projektakte të rëndësishme dhe me impakt, afati të jetë me i gjatë, pasi siç shohim edhe me poshtë as afati minimal prej 20 ditësh nuk zbatohet.

Fig. 6. dhe 7. Faqja Zyrtare e Bashkise, konsulto online, Njoftim për Këshillim me Publikun për disa ndryshime në Paketën Fiskale, fondet e Buxhetit për vitin 2018 me shpenzime dhe investime sipas programeve buxhetore, tavanet buxhetore për vitet 2019-2020.

www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_per_Keshillim_me_Publikun_per_disa_ndryshime_ne_Paketen_Fiskale_fondet_e_Buxhetit_per


Këshillim me Publikun

Njoftim për Këshillim me Publikun për disa ndryshime në Paketën Fiskale, fondet e Buxhetit për vitin 2018 me shpenzime dhe investime sipas programeve buxhetore, tavanet buxhetore për vitet 2019-2020

29.09.2017

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, ligjit 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", udhëzimin nr. 23 datë 22.11.2016 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 "Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar,

Bashkia Shkoder bën publik:



Jeni të ftuar të shprehni opinionin tuaj:

1. përmes [Forumit On-Line](#) të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër,
2. përmes adresës zyrtare e-mail info@bashkiashkoder.gov.al
3. përmes pjesëmarrjes tuaj në dëgjosat publike që do të mbahen sipas tabelës së mëposhtme:

www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_per_Keshillim_me_Publikun_per_disa_ndryshime_ne_Paketen_Fiskale_fondet_e_Buxhetit_per_viti

Nr	Data	Nësia Administrative	Ora	Vendi
1	E Enjte, <u>12 tetor</u> 2017	Velipojë Dajç	10:00 12:30	Njësia Administrative Velipojë, Salla e Mbledhjeve Njësia Administrative Dajç, Salla e Mbledhjeve
2	E Premte, <u>13 tetor</u> 2017	Bërdicë Ana e Malit	10:00 13:30	Njësia Administrative Bërdicë Njësia Administrative Ana e Malit, Salla e Mbledhjeve
3	E Shtune, <u>14 tetor</u> 2017	Guri i Zi Rrethina	11:00 12:00	Qendra Komunitare në Gurin e Zi Shkolla Tringe Smajlaj në Grudë të Re
4	E Hëne, <u>16 tetor</u> 2017	Lagje nr. 1 Postrribë	10:00 14:00	Salla e Këshillit të Bashkisë Shkodër Njësia Administrative Postrribë, Salla e Mbledhjeve
5	E Marte, <u>17 tetor</u> 2017	Lagje nr. 3 Lagje nr. 5	10:00	Salla e Këshillit të Bashkisë Shkodër
6	E Mërkure, <u>18 tetor</u> 2017	Lagje nr. 2 Lagje nr. 4	10:00	Salla e Këshillit të Bashkisë Shkodër

7.7 Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

Në pikën 19/3 të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, është përcaktuar se:

“Projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuar në nenin 11 të këtij ligji.”

Koment 10: Nga informacionet e grumbulluara, nuk rezulton zbatimi i një praktike të tillë, sikurse edhe në raportin e parë.


Në nenin 20 të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, është përcaktuar se organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- d) numrin e takimeve publike të organizuara.

Sa i përket publikimit, ligji parashikon që ky raport të publikohet në programin e transparencës në internet. Një raport i tillë është shumë rëndësishëm në kuadër të transparencës, sa kohë shërben si tregues për zbatimin e detyrimeve bazë të ligjit apo për rolin dhe efektivitetin e proceseve të konsultimit të kryera për vitin referues përkatës.

Koment 11: Nga informacionet e grumbulluara vazhdon e njejta situatë si në raportin e parë, nga ku nuk rezulton që të jetë hartuar ose publikuar ndonjë raport vjetor mbi transparencën në procesin e vendimmarrjes nga ana e Bashkisë Shkodër.

Shënim: Ky raport përpara prezantimit të tij i është dërguar Bashkisë Shkodër duke i kërkuar dhënien e komenteve në lidhje me gjetjet e raportit dhe duke caktuar si afat perfundimtarë ligjor për dërgimin e komenteve datën **15 Maj 2018**. Nga ana e Bashkisë Shkodër nuk ka patur asnjë përgjigje dhe nuk është dërguar asnjë koment çka tregon se gjetjet e raportit të mbështetura me referenca ligjore dhe fakte kanë qene me vend dhe janë pranuar të gjitha nga Bashkia Shkodër!

	“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
	“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
	L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
	SHKODER, ALBANIA
	TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al	
Date 25 Prill 2018	

KERKESE

Drejtuar: znj.Voltana Ademi, Kryetare e Bahkise Shkoder

E nderuar znj.Kryetare,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” e cila që nga muaji Maj 2016 është angazhuar plotësisht në monitorimin e progresit të procesit të konsultimeve në Bashkinë e Shkodrës, ka publikuar sot Progres Raportin mbi Procesin e Konsultimeve në Bashkinë Shkodër në zbatim të ligjit Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Progres Raporti mbi Procesin e Konsultimeve në Bashkinë Shkodër analizon zbatimin e legjislacionit për konsultimet publike, progresin e bërë nga Bashkia Shkodër dhe evidenton problematikat në zbatimin e ligjit.

Progres raporti evidenton se nga 19 kritere të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, vetëm 4 nga këto kritere plotësohen nga Bashkia Shkodër gjatë organizimit dhe zhvillimit të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. E pasqyruar në përqindje rezulton së Bashkia Shkodër e zbaton në masën 21%, ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Ndërsa në krahasim me progresin e arritur nga monitorimi i mëparshëm, për zbatimin e këtij ligji i shprehur në përqindje progresi është në masën 10%. Nëse në Raportin e Prillit 2016, Bashkia Shkodër kishte plotësuar vetëm 2 kritere nga ato që parashikon ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, sot rezulton se plotësohen ne total 4 kritere nga 19 kritere të parashikuara.

Dy prej problematikave kryesore të cilat rezultojnë në këtë progres raport janë: mungesa e koordinorit për njoftimet dhe konsultimet publike dhe mosrespektimi i afateve të njoftimeve për konsultimin publik.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti synojnë që të inkurajojnë drejtuesit lokal në drejtim të zbatimit korrekt të ligjit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të procesit të konsultimit dhe përfshirjes aktive të qytetarëve në vendimarrjen lokale e cila do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes dhe të shërbimeve në nivel lokal.

Persa mesiper lidhur mesa eshte referuar ne progres raportin tone organizata “Intelektualet e rinj, Shprese”perpara se te publikoj versionin final te raportit do te vleresonte shume te merrnim komentet apo sugjerimet tuaja brenda dates 15 Maj 2018.



Me respekt

*Saimir Beqiraga
President i IRSH*